



## KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

### VENDIM

Nr. 28 datë 02.04.2009

### ***PËR MIRATIMIN E INISIATIVAVE FISKALE NË LIDHJE ME TARIFËN E REGJISTRIMIT (PËR LEJE USHTRIMI VEPRIMTARIE EKONOMIKE) PËR VITIN 2009***

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot në datë 02.04.2009 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Marketingut si dhe bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35, Ligjin Nr.8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 8 “Të drejtat e njësisë së qeverisjes vendore”, pika II “E drejta e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve”, gërma b e cila parashikon të drejtën e “vendosjes së taksave dhe tarifave për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkisë”, nenin 16 “Të ardhurat e veta të komunës dhe Bashkisë”, pika 2 e cila parashikon “...komuna dhe bashkia kanë të drejtë të zbatojnë ose jo një taksë ose tatim vendor të përcaktuar”, neni 32 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal ose bashkiak”, gërma f e cila parashikon të drejtën e “vendosjes për taksat dhe tarifat vendore si dhe nivelin e tyre”, Ligjin nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” si dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr 24 datë 02.09.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” :

### VENDOSI

- 1- Të miratojë iniciativat fiskale në lidhje me tarifën e regjistrimit (për leje ushtrimi veprimtarie ekonomike) për vitin 2009 sipas pasqyrës bashkëngjitur.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha strukturat e Bashkisë Korçë veçanërisht Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Marketingut.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Rajmonda NASE**

*Rajmonda Nase*